



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:014695

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528944

KPPP.nr.89/24

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, me adresë Instituti B, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së në Prishtinë, kundër debitorit IPSH “Arizona”, me adresë Rr. “18 Qershori, Komuna Skënderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve PRO JURIS, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.484/23, të datës 14.12.2023, të Përmbartuesit Privat Fazli Gjonbalaj me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datën 29.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit debitorit IPSH “Arizona”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.484/23, të datës 14.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Inspektorati Shëndetësor, ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr.484/23, të datës 14.12.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin IPSH “Arizona”, sipas dokumentit përmbartimor Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/AJ-043-22 të datës 18.05.2022, që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 4,000.00 € (katër mijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas tarifës së përmbartuesve, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) , ngase dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përmbartues, nuk është i përshtatshëm për përmbartim, pasi nuk i plotëson kërkesat e nenit 71 par.1.1 të LPP-së. Më tej ka theksuar se vendimi është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe për këtë arsye për të njëjtën çështje është paraqitur padi për anulimin e vendimit të organit administrativ, të datës 29.06.2023, dhe me paraqitjen e kësaj padie e bën vendimin e lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor të papërmbartueshëm, duke mos i plotësuar tiparet për përmbartueshmëri. Ka shtuar se vendimi është i pa bazë dhe jo i ligjshëm për arsye se Inspektorati Shëndetësor me asnjë provë të vetme nuk e ka vërtetuar faktin se mbi çfarë baze e ka shqiptuar dënimin në vlerë prej 4,000.00 Euro. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në prapësimi, ndërsa të anulohet urdhri për përmbartim i Përmbartuesit Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbartimore në tërësi.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktvendimin Nr.10/Aj-043-22 të datës 18.05.2022, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr.10/Aj-043-22 i datës 18.05.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për*

përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguajë debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.10/Aj-043-22 i datës 18.05.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarrueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase aktvendimi i lartcekur, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor, është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm më datë 14.11.2023.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se ka ushtruar padi për anulimin e vendimit të organit administrativ, mirëpo e gjeti si të pabazuar ngase në bazë të nenit 22 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”,* dhe konform kësaj dispozite ligjore vendimi i tillë i plotëson tiparet e përmbarrueshmërisë, dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë pengesë për zbatimin e përmbarrimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.89/24, më datë 29.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.